



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO
REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT E
SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË

MINISTARSTVO OBRAZOVANJA
NAUKE I TEHNOLOGIJE

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY

TESTI I MATURËS

GJIMNAZI MATEMATIKË - INFORMATIKË

Emri dhe mbiemri i nxënësit

Shkolla.....


MATEMATIKË

FIZIKË

KIMI

BIOLOGJI

INFORMATIKË




Prishtinë, qershor 2015

Udhëzime:

Koha: Keni 180 minuta që t'ju përgjigjeni 80 kërkesave (pyetjeve). Koha numërohet prej momentit kur do të filloni t'ju zgjidhni kërkesat.

Si të veproni?

1. Plotësojini me kujdes, sipas udhëzimeve, të gjitha kodet (në rreth), për: komunën, shkollën, paralelen, numrin e ditarit. Nëse këto të dhëna nuk i plotësoni saktë, nuk do të mund të nxirret rezultati i testit tuaj.
2. Para se të filloni t'ju përgjigjeni pyetjeve, qetësohuni plotësisht, sepse kjo do t'ju ndihmojë.
3. Lexojini me kujdes kërkesat dhe pastaj shënojeni vetëm përgjigjen e saktë, nga 4 mundësitë e dhëna, për të cilën besoni se është e saktë.
4. Fleta e përgjigjeve duhet të plotësohet vetëm me laps të thjeshtë - laps HB.
5. Mbusheni kodin (në rreth) e përgjigjes së saktë me laps të thjeshtë, pa e shkarravitur jashtë. Shih shembullin e mëposhtëm.



6. Kini kujdes që përgjigjen e saktë të një pyetjeje të mos ia vendosni pyetjes tjetër të radhës.
7. Në Fletën e përgjigjeve nuk bën të shkruani tjetër gjë, përveç përgjigjeve për të cilat jeni të bindur se janë të sakta.
8. Përgjigjet e sakta plotësohen njëkohësisht – në Test dhe në Fletën e përgjigjeve.
9. Çdo lloj llogaritjeje mund ta bëni në faqen e fundit të testit, ndërsa në fletën e përgjigjeve nuk bën të shkruani tjetër gjë, përveç përgjigjeve, për të cilat jeni të bindur se janë të sakta.
10. Mos humbni kohë me pyetjet që nuk i dini, sepse koha mund të mos ju mjaftojë për pyetjet e tjera.
11. Përdoreni deri në fund kohën e testimit, në mënyrë që t'ju përgjigjeni të gjitha pyetjeve.

MATEMATIKË

1. Janë dhënë matricat $A = \begin{bmatrix} 1 & -2 \\ 0 & 3 \end{bmatrix}$, $B = \begin{bmatrix} 1 & 3 \\ -1 & 2 \end{bmatrix}$, $C = \begin{bmatrix} 2 & 0 \\ 1 & 5 \end{bmatrix}$. Cila është $3A - 2B + C^T$?


- A. $\begin{bmatrix} 3 & -2 \\ 2 & 10 \end{bmatrix}$
- B. $\begin{bmatrix} 3 & -11 \\ 2 & 10 \end{bmatrix}$
- C. $\begin{bmatrix} 5 & 2 \\ -2 & 3 \end{bmatrix}$
- D. $\begin{bmatrix} 3 & -12 \\ 1 & 5 \end{bmatrix}$

2. Është dhënë sistemi i ekuacioneve $\begin{cases} x + ay = 2 \\ ax + 4y = 4 \end{cases}$. Për çfarë vlerë të parametrit a sistemi i ekuacioneve është i mundshëm dhe i caktuar?

- A. $a \neq 0$
- B. $a \neq \pm 1$
- C. $a \neq \pm \infty$
- D. $a \neq \pm 2$

3. Në bazë të situatës së dhënë në figurë tregoni sa është vlera e x - it?

- A. 21
- B. 12
- C. 15
- D. 18



4. Sa është gjasa që gjatë një hedhje të njëkohshme të dy zareve, shuma e pikëve që bien në faqen e sipërme të tyre të jetë 7?

- A. $\frac{1}{12}$
- B. $\frac{1}{6}$
- C. $\frac{1}{18}$
- D. $\frac{1}{36}$



5. Zana në testin e parë të matematikës arriti 64 pikë, ndërsa në testin e dytë arriti 78 pikë. Sa pikë duhet të marr ajo në testin e tretë ashtu që të arrijë mesataren e përgjithshme prej 80 pikësh?

- A. 98 pikë
- B. 88 pikë
- C. 100 pikë
- D. 95 pikë

6. Sa numra 2-shifrorë mund të fitohen nga numrat 1 deri 9 në të cilët shuma e shifrave është e barabartë me 13 ?
- A. 6
B. 11
C. 8
D. 5
7. Le të jenë $*$ dhe \circ janë dy veprime binare të përkufizuara në bashkësinë e numrave të plotë \mathbb{Z} , $x * y = 2x - 3y + 5$ dhe $x \circ y = x + 5y + 1$.
Sa është vlera e shprehjes: $(2 * 1) \circ 5$?
- A. 10
B. 12
C. 23
D. 32
8. Është dhënë funksioni $f(x) = \frac{x-1}{x}$, për $x \neq 0$. Cili është funksioni inver $f^{-1}(x)$?
- A. $f^{-1}(x) = \frac{x}{x-1}$
B. $f^{-1}(x) = \frac{1}{1-x}$
C. $f^{-1}(x) = \frac{1}{x-1}$
D. $f^{-1}(x) = \frac{x}{1-x}$
9. Cili është prodhimi i përzier $(\vec{a} \times \vec{b}) \cdot \vec{c}$ i vektorëve $\vec{a} = (1, 0, 2)$, $\vec{b} = (0, 2, -1)$ dhe $\vec{c} = (1, 2, 3)$?
- A. 4
B. 3
C. 2
D. 1
10. Nëse x është zgjidhje e ekuacionit $\log_7(3-2x) = 0$, sa është vlera e $x - \frac{1}{2}$?
- A. $\frac{3}{2}$
B. $-\frac{3}{2}$
C. $\frac{1}{2}$
D. $-\frac{1}{2}$

11. Cila është forma e thjeshtuar e shprehjes $\frac{\cos x + \sin x}{1 + \tan x}$

- A. $\cos x$
- B. $\sin x$
- C. $\tan x$
- D. $\cot x$

12. Katër nxënësve u është shtruar detyra:
Shënoni shprehjen që paraqet shumën e çfarëdo tre numrave të njëpasnjëshëm tek.

Përgjigjet e tyre janë shënuar në tabelë:
Cili nxënës është përgjegjës saktë?

- A. Nxënësi 4
- B. Nxënësi 3
- C. Nxënësi 2
- D. Nxënësi 1

Nxënësi 1.	$1+3+5$
Nxënësi 2.	$n+(n+1)+(n+2)=3n+3$
Nxënësi 3.	$(2n-1)+(2n+1)+(2n+3)=6n+3$
Nxënësi 4.	$5+7+9=21$

13. Janë dhënë polinomet $p(x) = x^3 - 2x^2 - x$; $q(x) = x^4 - 3x^2 + x$. Sa është shkalla e polinomit

$$\frac{p(x) \cdot q(x)}{x^2} ?$$

- A. 3
- B. 4
- C. 6
- D. 5

14. Një punëtor në ditën e parë mblodhi 40 kg dredhëza, ndërsa për çdo ditë tjetër ai mblodhi nga 5 kg më shumë se në ditën paraprake. Për çdo kilogram dredhëzash të mblodhura paguhej me nga 0.2 €. Sa euro i fitoi punëtori për 10 ditë pune?

- A. 127 €
- B. 135 €
- C. 125 €
- D. 137 €

15. Është dhënë tabela:

x	$f(x)$	$f'(x)$	$g(x)$	$g'(x)$
1	2	-1	1	1
2	1	1/2	2	1
3	3	2	3	1

Sa është $h'(2)$ nëse $h(x) = f(x) - g(x)$?

- A. $\frac{1}{2}$
- B. $-\frac{1}{2}$
- C. $-\frac{1}{3}$
- D. $\frac{1}{3}$

16. Cila është domena (bashkësia e vlerave) e funksionit $f(x) = \frac{\sqrt{x+4}}{1-x}$?

- A. $D(f) = (1, \infty)$
- B. $D(f) = [-4, 1)$
- C. $D(f) = [-4, 1) \cup (1, \infty)$
- D. $D(f) = (-\infty, 1) \cup (1, 4)$

17. Perimetri i bazës së një koni të drejtë është 10π cm, ndërsa lartësia e tij është 9cm. Sa është vëllimi i atj konit?


- A. $V = 75\pi \text{ cm}^3$
- B. $V = 70\pi \text{ cm}^3$
- C. $V = 80\pi \text{ cm}^3$
- D. $V = 85\pi \text{ cm}^3$

18. Është dhënë funksioni $f(x) = x \cdot \ln x$. Sa është derivati i funksionit të dhënë për vlerën $x = e$?

- A. 0
- B. 1
- C. 3
- D. 2

19. Cili është ekuacioni i drejtëzës d , e dhënë në figurë?

- A. $d: 5x + 4y - 20 = 0$
- B. $d: 4x + 5y + 20 = 0$
- C. $d: 5x - 4y + 20 = 0$
- D. $d: 4x - 4y - 20 = 0$



20. Një nxënës në Testin e Maturës Shtetërore ka arritur këtë numër të përgjigjeve të sakta: Gjuhë amtare (37 nga 50), Gjuhë angleze (33 nga 40), Matematikë (20 nga 30). Sa % të pikëve i ka arritur ai nxënës në Testin e Maturës Shtetërore?

- A. 55%
- B. 65%
- C. 75%
- D. 85%

21. Cila është zgjidhja e ekuacionit $\log_2(2\log_x(2x-3)) = 1$?

- A. 3
- B. 2
- C. 1
- D. 0

22. Funkcionet f dhe g janë dhënë në mënyrë tabelare, për të cilat kompozimi është përkufizuar me $(f \circ g)(x) = g(f(x))$.

Sa është $(f \circ g)(3)$?

- A. 4
- B. 1
- C. 3
- D. 2

x	1	2	3	4
$f(x)$	3	4	2	1

x	1	2	3	4
$g(x)$	4	1	3	2


23...Në një zyrë pune, temperatura kontrollohet me një termostat elektronik. Temperatura ndryshon sipas funksionit $y = 19 + 6\sin\left(\frac{\pi}{12}(x-11)\right)$, ku y është temperatura në $^{\circ}\text{C}$ dhe x është numri i orëve pas mesnatës.

Sa është temperatura në zyrë, në ora 9:00 të mëngjesit?

- A. 14°C
- B. 18°C
- C. 16°C
- D. 20°C

24. Cili është ekuacioni i rrethit të paraqitur në figurën?

- A. $(x - 2)^2 + (y + 1)^2 = 25$
- B. $(x - 7)^2 + (y - 1)^2 = 25$
- C. $(x - 3)^2 + (y - 7)^2 = 25$
- D. $(x + 2)^2 + (y - 1)^2 = 25$



25. Sa është $\lim_{x \rightarrow 9} \frac{\sqrt{x} - 3}{x - 9}$?

- A. 0
- B. $\frac{1}{6}$
- C. ∞
- D. $\frac{1}{9}$

26. Një lloj bakteriesh dyfishohen në çdo minutë. Nëse në fillim, në një enë laboe ratorike numri i tyre ka qenë 1000. Sa do të jetë numri i bakterieve në minutën e shtatë?


- A. 64000
- B. 32000
- C. 52000
- D. 84000

27. Në kabinetin e informatikës kompjuterët janë lidhur mes veti me lidhje optike. Numri i përgjithshëm i lidhjeve optike është dhënë me formulën $f(n) = \frac{n(n-3)}{2} + n$, ku n është numri i kompjuterëve. Nëse numri i përgjithshëm i lidhjeve optike është 28, atëherë sa kompjuterë ka në këtë kabinet?

- A. 10
- B. 8
- C. 7
- D. 9

28. Trekëndëshi $A'B'C'$ është fituar nga trekëndëshi ABC , me anë të një transformimi izometrik të vetëm.

- A. Simetri boshtore
- B. Simetri qendrore
- C. Translacion
- D. Rotacion



29. Cila është zgjidhje e ekuacionit trigonometrik: $2\sin^2 x + 5\cos x + 1 = 0$ për $x \in [\pi, 2\pi]$?

- A. $\frac{4\pi}{3}$
- B. $\frac{\pi}{3}$
- C. $\frac{5\pi}{3}$
- D. $\frac{7\pi}{3}$

30. Sa është vlera e shprehjes $\sin 122^\circ \cdot \cos 32^\circ - \cos 122^\circ \cdot \sin 32^\circ$?

- A. 0
- B. 1
- C. -2
- D. -1

FIZIKË

31. Në enën e mbyllur më vëllim V_0 gjenden N_0 molekula të një gazi ideal me ç' rast përqëndrimi i molekulave do të jetë n_0 . Sa do të jetë përqëndrimi molekulave të gazit të njëjtë me numër të njëjtë N_0 nëse vëllimi i enës dyfishohet?

- A. $n = 2n_0$
- B. $n = \sqrt{2}n_0$
- C. $n = \frac{n_0}{\sqrt{2}}$
- D. $n = \frac{n_0}{2}$


32. Në pjesën nënujore të anijes në thellësinë $h = 5m$ është krijuar një hapje me sipërfaqe $S = 0,01m^2$. Sa duhet të jetë forca minimale e veprimit në hapje që të mos lejohet futja e ujit në anije, nëse densiteti i ujit merret $\rho = 1000 \frac{kg}{m^3}$, ndërsa nxitimi i gravitetit

$$g = 10 \frac{m}{s^2} ?$$

- A. $500N$
- B. $5N$
- C. $50N$
- D. $5000N$

33. Cila nga këto thjerra përdoret te syzet kur kemi dioptri pozitive (shih.fig.) ?

- A. IV
- B. III
- C. II
- D. I




34. Në cilin nga rastet kemi burim të fushës magnetike?

- A. Kur një grimcë e elektrizuar lëvizë
- B. Kur një grimcë neutrale lëvizë në vijë të drejtë
- C. Kur një grimcë neutrale lëvizë në trajektore rrethore
- D. Kur një grimcë e elektrizuar nuk lëvizë

35. Çfarë pune kryhet në enën e mbushur me gaz në shtypje konstante, nëse rritet vëllimi i enës nga V_1 në $V_2 = mV_1$?

- A. $A = mp V_1$
- B. $A = (m+1) pV_1$
- C. $A = (m-1) pV_1$
- D. $A = (1-m) pV_1$

36. Nëse një rreze drite kalon nga ajri në qelq nën këndin e rënies 0° , atëherë cili nga pohimet vijuese është i saktë?



- A. Shpejtësia e rrezeve të dritës mbetet e njëjtë, ndërsa drejtimi i rrezeve të dritës ndryshon
- B. Shpejtësia e rrezeve të dritës zvogëlohet, ndërsa drejtimi i rrezeve të dritës mbetet i njëjtë
- C. Drejtimi i përhapjes së rrezeve të dritës ndryshon, ndërsa shpejtësia e rrezeve të dritës mbetet e njëjtë
- D. Drejtimi i përhapjes së rrezeve të dritës mbetet i njëjtë, ndërsa shpejtësia e rrezeve të dritës në qelq rritet

37. Nëse shufra e njëjtë metalike me gjatësi dhe temperaturë fillestare të njëjtë i nënshtrohet veprimit të nxehtësisë për katër herë asaj do t'i ndryshojë temperatura. (shih tabelën). Në cilin nga rastet ndodh ndryshimi maksimal i gjatësisë së shufrës?

- A. 2
- B. 3
- C. 4
- D. 1

Nr.	$\Delta t = t - t_0$
1	5°C
2	50°C
3	$\frac{1}{5}^\circ\text{C}$
4	$\frac{1}{50}^\circ\text{C}$

38. Cila nga formulat e shënuara paraqet shpejtësinë e një vale?


- A. $v = \frac{T}{\lambda}$
- B. $v = \lambda \cdot T$
- C. $v = \lambda^2 \cdot T$
- D. $v = \frac{\lambda}{T}$

39. Si quhet rrymimi i fluidit në rast se vijat e rrymimit janë paralele mes veti?

- A. Laminar
- B. Jostacionar
- C. Stacionar
- D. Turbulent

40. Një makinë lëvizë nëpër trajektore me rreze (r) si në figurë. Në cilin nga drejtimet e horizontit është vektori i shpejtësisë lineare (v)?

- A. Jug
- B. Veri
- C. Lindje
- D. Perëndim




41. Për cilën nga madhësitë fizike N (Njutni) është njësi matëse?

- A. Energjinë
- B. Shtypjen
- C. Peshën
- D. Masën

42. Një tel i drejtë lëvizë duke rritur shpejtësinë normal me vijat e fushës magnetike si në figurë. Çka ndodh me tensionin në skajet e përçuesit?

- A. Bëhet zero
- B. Rritet
- C. Zvogëlohet
- D. Nuk ndryshon



43. Sa do të jetë energjia potenciale e ngarkesës me masë $m = 5\text{kg}$ nëse ajo ngritet në lartësinë $h = 2\text{m}$ dhe nëse $g = 10 \frac{\text{m}}{\text{s}^2}$?


- A. 100J
- B. 1000J
- C. 10J
- D. 1J

44. Me çfarë shpejtësie përhapet vala longitudinale me gjatësi valore $\lambda = 2\text{m}$ dhe frekuencë $\nu = 100\text{Hz}$?

- A. $\nu = 0.02 \frac{\text{m}}{\text{s}}$
- B. $\nu = 0.2 \frac{\text{m}}{\text{s}}$
- C. $\nu = 200 \frac{\text{m}}{\text{s}}$
- D. $\nu = 50 \frac{\text{m}}{\text{s}}$


45. Në figurën e mëposhtme janë paraqitur dy valë që përhapen në mjedis të njëjtë, me shpejtësi të barabarta, në drejtim të njëjtë por me kahje të kundërta. Cila dukuri do të paraqitet kur valët gjenden ndërmjet pikave C dhe D?

- A. Difraksioni
- B. Polarizimi
- C. Efekti i Doplerit
- D. Interferenca e valëve



46. Cili është emri i këtij komponimi i cili është i paraqitur me formulën strukturore?

- A. Alanina
- B. Glicina
- C. Leucina
- D. Serina



47. Çfarë rrjete kristalore ka kloruri i natriumit?

- A. Rrjetë kristalore metalike
- B. Rrjetë kristalore kovalente
- C. Rrjetë kristalore jonike
- D. Rrjetë kristalore molekulare


48. Numri i komponimeve organike në jetën e përditshme është shumë i madh:

- A. sepse atomet e karbonit lidhen në mes veti në disa mënyra
- B. sepse atomet e karbonit lidhen me të gjitha elementet kimike
- C. sepse ekzistojnë katër modifikime alotropike të atomit të karbonit
- D. sepse karboni formon komponime me lidhje jonike dhe lidhje kovalente

49. Cili oksid kur tretet në ujë letrën e kaltër të lakmusit e shndërron në të kuqe ?


- A. CO
- B. Na₂O
- C. SO₃
- D. CaO

50. Gjatë procesit të fotosintezës energjia diellore shndërrohet në energji kimike dhe zhvillohet reaksioni kimik:



Sa gram glukozë (C₆H₁₂O₆) do të përftohen nëse gjatë këtij reaksioni janë absorbuar 5632 kJ? Nëse: Ar(C)=12.0, Ar(H)=1.0, Ar(O)=16.0

- A. 45 g
- B. 360 g
- C. 90 g
- D. 180 g



51. Cili sheqer identikohet me reagjent të Fehlingut?

- A. Eritruloza
- B. Ribuloza
- C. Sorboza
- D. Riboza

52. Cili nga reaksionet e mëposhtme paraqet reaksion të formimit të precipitatit (fundërrinës)?

- A. $\text{AgNO}_3 + \text{NaCl} = \text{AgCl} + \text{NaNO}_3$
- B. $\text{AgCl} + 2\text{NH}_3 = [\text{Ag}(\text{NH}_3)_2]\text{Cl}$
- C. $\text{Cr}(\text{OH})_3 + 3\text{HCl} = \text{CrCl}_3 + 3\text{H}_2\text{O}$
- D. $\text{Cr}(\text{OH})_3 + 3\text{NaOH} = \text{Na}_3[\text{Cr}(\text{OH})_6]$

53. Sa protone dhe sa elektrone ndodhen në jonin e azotit ${}^{14}_7\text{N}^{3-}$?

- A. 7 protone dhe 4 elektrone
- B. 7 protone dhe 10 elektrone
- C. 14 protone dhe 10 elektrone
- D. 14 protone dhe 7 elektrone

54. Cili grup në sistemin periodik të gjitha elementet i ka gazra?

- A. Grupi 15
- B. Grupi 16
- C. Grupi 17
- D. Grupi 18

55. Sa është numri oksidues i oksigjenit në jonin bikarbonat HCO_3^- ?

- A. -1
- B. -2
- C. -3
- D. -4

BIOLOGJI

56. Skeleti i kurrizit i takon:

- A. skeletit boshtor
- B. skeletit lëkuror
- C. skeletit të brezeve
- D. skeletit të gjymtyrëve

57. Cilat organele qelizore i sintetizojnë proteinat?

- A. Plastidet
- B. Lizozomet
- C. Ribozomet
- D. Centrozomet

58. Si quhet kromozomi kur njëri krah i tij është më i madh ndërsa tjetri krah është shumë më i vogël?

- A. Akrocentrik
- B. Submetacentrik
- C. Metacentrik
- D. Teleocentrik

59. Te cili nga indet e poshtëshënuara shfaqen probleme në funksionimin normal të tij, nëse dëmtohet miozina?


- A. Indi i ashtit
- B. Indi i nervit
- C. Indi i gjakut
- D. Indi i muskulit

60. Në cilin nga këto biome jeton bizoni si bimëngrënës?

- A. Shkretëtira
- B. Stepe
- C. Pyje tropikale
- D. Pyje gjethegjera

61. Për cilën gjëndër bëhet fjalë nëse kemi këto të dhëna?

- A. Mëlçia
- B. Epifiza
- C. Pankreasi
- D. Hipofiza



62. Si quhen qelizat që marrin pjesë në këmbimin e gazrave në organizëm?

- A. Eritrocite
- B. Osteocite
- C. Miocite
- D. Leukocite

63.Cili organ ndërlidhet saktë me funksionin e tij që e kryen?

- A. Mezonefrosi → Këmbimi i gazrave
- B. Tiroidea → Hormoni T3
- C. Mëlçia → Insulina
- D. Truri i mesëm → Drejtpeshimi

64. Cikli pentozik fillon me glukozë-6-fosfat dhe përfundon me:

- A. glukozë- 6-fosfat
- B. glukozë- 3-fosfat
- C. glukozë- 4-fosfat
- D. .glukozë- 5-fosfat

65.Nëse vie deri te kryqëzimi i grurit me kërcell të gjatë TT me grurin me kërcell të shkurtër tt, çfarë përqindje të kërcellit të shkurtër do të kenë pasardhësit e gjeneratës F₂?

- A. 33%
- B. 25%
- C. 50%
- D. 75%

INFORMATIKË

66. Për të vendosur një regjister ose numërues në pozitën zero, duhet të përdoret opsioni :

- A. Remote
- B. Return
- C. Reset
- D. Release

67. Si quhet memoria e përkohshme e të dhënave, e cila ndodhet ndërmjet njësisë qendrore procesorike dhe njësisë periferike dhe e cila ruan të dhënat që presin radhën për ekzekutim, si pasojë e mospërputhjes së shpejtësisë së komunikimit ndërmjet njësive përkatëse:

- A. Temporary storage
- B. Backing storage
- C. Main storage
- D. Buffer

68. Instruksionet dhe adresat e memories paraqiten me:

- A. Kode binare
- B. Kode të karaktereve
- C. Bite të paritetit
- D. Kode ternare

69. Opsioni System Restore do të bëjë të mundur:

- A. Rikthimin e të dhënave që janë fshirë rastësisht
- B. Kthimin e gjendjes së sistemit në një moment para dëmtimit të tij
- C. Instalimin e sërishëm të sistemit operativ
- D. Instalimin e sërishëm të programeve aplikative

70. Sa do të jetë vlerë numerike që fitohet pas ekzekutimit të funksionit “=ROUNDUP(0.1223,2)”, në programin MS Excel:

- A. 0.1
- B. 0.2
- C. 0.13
- D. 0.123

71. Pas ekzekutimit të funksionit të treguar në figurë, vlera e qelulës C2 do të jetë:

- A. False
- B. N/A
- C. @Error
- D. True

	A	B	C	D	E	F
1						
2	Subjekti 1	56	=OR(B2<57,B3<46,B4<68)			
3	Subjekti 2	45				
4	Subjekti 3	67				
5						

72. Opcioni i treguar në figurë, i programit MS PowerPoint, mundëson:

- A. Vetëm krahasimin e prezantimit aktual me një tjetër
- B. Vetëm kombinimin e prezantimit aktual me një tjetër
- C. Krahasimin dhe kombinimin e prezantimit aktual me një tjetër
- D. Ndryshimet e krahasimit të prezantimit aktual



73. Në adresën <http://www.search.ieice.org>, pjesa e cila specifikon protokolin për komunikim është:

- A. http
- B. www.
- C. search.
- D. ieice.org

74. Sa është shuma e numrave binar: $11001+10011$?

- A. 100011
- B. 101100
- C. 111110
- D. 111111

75. Pas ekzekutimit të programit të paraqitur në figurë, në ekran paraqitet formulimi “teksti hyrës:” . Nëse në tastier shtypet teksti “Matura”, rezultati dalës do të jetë:

- A. Teksti hyrës: Matura
- B. Matura
- C. Teksti hyrës-Teksti dalës: Matura
- D. Teksti i lexuar: Matura

```
// Programi teksti
#include <iostream>
using namespace std;
int main()
{
    char a[15];
    cout << "Teksti hyrës: ";
    cin >> a ;
    cout << "\nTeksti i lexuar: "
         << a
         << "\n";
    return 0;
}
```

76. Cila prej shprehjeve të listuara më poshtë ka të bëjë me mësimin nëpërmjet kompjuterit, përkatësisht mësimin në distancë:

- A. E-word
- B. M-commerce
- C. E-learning
- D. M- library

77. Nëse një sinjal elektrik $A=10100$ kyçet në portin Not Gate, në dalje do të fitohet:

- A. 10001
- B. 01011
- C. 10101
- D. 00101

78. Sa është numri i gjendjeve që mund të fitohen me një kod 7 bitësh:

- A. 1024
- B. 512
- C. 256
- D. 128

79. Një shifër për identifikim (password) preferohet të ketë:

- A. Shkronja të mëdha, shkronja të vogla, numra dhe shenja të interpunkcionit.
- B. Shkronja të vogla, numra dhe shenja të interpunkcionit
- C. Shkronja të mëdha dhe numra
- D. Shkronja të vogla dhe numra

80. Cila prej memorieve vijuese duhet të rifreskohet shumë herë në një sekond:

- A. RAM-i statik
- B. EPROM
- C. ROM
- D. Ram-i dinamik